



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**  
**www.uni-gjilan.net tel: 0280390112**

---

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi      Ref.nr.01/640      Dt. /01/06/2018

---

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr. 04/L-037, si dhe nenit 48, paragrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i UKZ-së në mbledhjen e XXI të mbajtur më 19.04.2018, merr vendim për të shpallur:

## **K O N K U R S**

**Për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan**

### **FAKULTETI I EDUKIMIT**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Psikologji e fëmijës, Psikologji e edukimit, Psikologji personaliteti, Psikologji e zhvillimit dhe personalitetit, Psikologji e lojës.
2. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga pedagogjia.
3. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga matematika.
4. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga shëndetësia (me gjysmë normë).
5. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga kultura fizike (me gjysmë normë).
6. Një ligjërues për lëndët (ligjërata dhe ushtrime) Bazat e arsimit muzikor me metodologji, Interpretim në një instrument muzikor, Lojërat muzikore tradicionale.
7. Një asistent për grup lëndësh nga pedagogjia.

### **FAKULTETI EKONOMIK**

8. Një profesor për grup lëndësh nga menaxhmenti.
9. Një profesor për grup lëndësh nga ekonomiksi.
10. Një profesor për grup lëndësh nga marketingu.
11. Një profesor për grup lëndësh nga financat dhe kontabiliteti.

### **FAKULTETI JURIDIK**

12. Një mësimdhënës për lëndë nga fusha juridik civil.
13. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga ekonomia.
14. Një mësimdhënës për lëndët nga fusha juridik penal.

### **FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

15. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në grafikën e kompjuterëve, Hyrje në inteligjencë artificiale, Sensorët dhe interfejsi, Vizualizimi dhe procesimi i imazheve dhe lëndët tjera nga fusha e kompjuterëve.
16. Një asistent për lëndët: Inxhinieri softuerike, Databaza dhe lëndë të tjera nga fusha e kompjuterëve.

## **Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoraturës, të noterizuara;
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimeve;
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës);
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies;
- Dëshmi se ndaj tij nuk zhvillohen hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore;

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet bachelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

1. Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Statutin e Përkohshëm të Universitetit Kadri Zeka në Gjilan, në veçanti ato që parashihen në nenin 155,156,157, 158, 159 të këtij Statuti (shih: <http://uni-gjilan.net/dokumente-relevante/> )

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit (04.06.2018 deri më 18.06.2018).**

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Zyrën nr.4.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit: <http://www.uni-gjilan.net>